



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06

Prokurori kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit

Vendosi: Gjykatësi i Procedurës Paraprake

Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 25 maj 2021

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim për Miratimin e Kërkesës për Tërheqje të Mbrojtësit të Hashim Thaçit

Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

Mbrojtësit të Hashim Thaçit

Dejvid Huper

Mbrojtësit të viktimave

Sajmon Loz

Mbrojtësit të Kadri Veselit

Ben Emerson

Mbrojtësit të Rexhep Selimit

Dejvid Jang

Mbrojtëses së Jakup Krasniqit

Venkatesvari Alagenda

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ në pajtim me nenet 21(4)(e) dhe 5(a), dhe 39(1) dhe (13) të Ligjit nr.05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe pjesën 16(1) të Direktivës për Mbrojtësit, lëshon këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL DHE PARASHTRIMET

1. Më 5 nëntor 2020, Administratorja njoftoi Gjykatësin e Procedurës Paraprake për emërimin e Dejvid Huperit ("z. Huper") si mbrojtës të Hashim Thaçit ("z. Thaçi").²

2. Ndërmjet datave 9 nëntor 2020 dhe 1 dhjetor 2020, Administratorja njoftoi Gjykatësin e Procedurës Paraprake për miratimin e Dastid Pallaskës, Samuel Blom-Kuperit, Pier-Riçard Prosperit dhe Sofi Menegonit si bashkëmbrojtës të z. Thaçi.³

3. Më 20 maj 2021, Administratorja njoftoi Gjykatësin e Procedurës Paraprake se z. Thaçi i kishte kërkuar Zyrës së Mbrojtjes të emëronte z. Gregori Kihou ("z. Kihou") si mbrojtës të tij dhe se, me kërkesë të z. Thaçi, z. Huper kishte kërkuar të tërhiqej.⁴ Rrjedhimisht, Administratorja i kërkoi Gjykatësit të Procedurës Paraprake që të miratonte përfundimin e parakohshëm të përfaqësimit

¹ KSC-BC-2020-06, F00001, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 23 prill 2020, publik.

² KSC-BC-2020-06, F00053, Administratorja, *Njoftimi i Pranimin të Hashim Thaçit në Objektin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara dhe mbi Emërimin e Mbrojtësit*, 5 nëntor 2020, publik, para. 3-6, me shtojcat 1-2, përkatësisht publike dhe konfidenciale.

³ KSC-BC-2020-06, F00066, Administratorja, *Njoftim i Miratimit të Bashkëmbrojtësit për Hashim Thaçin*, 9 nëntor 2020, publik, me shtojcën 1, konfidenciale; F00080, Administratorja, *Njoftim i Miratimit të Bashkëmbrojtësit për Hashim Thaçin*, 16 nëntor 2020, publik, me shtojcën 1, konfidenciale; F00086, *Njoftim i Miratimit të Bashkëmbrojtësit për Hashim Thaçin*, 17 nëntor 2020, publik, me shtojcën 1, konfidenciale; F00114, Administratorja, *Njoftim i Miratimit të Bashkëmbrojtësit për Hashim Thaçin*, 1 dhjetor 2020, me shtojcën 1, konfidenciale.

⁴ KSC-BC-2020-06, F00317, Administratorja, *Njoftim i Kërkesës për Tërheqje të Mbrojtësit të Hashim Thaçit ("Kërkesa")*, 20 maj 2021, publike, para. 2-3, me shtojcën 1, konfidenciale dhe *ex parte*.

të z. Thaçi nga z. Huper.⁵ Administratorja parashtrroi se z. Kihou ishte pranuar në Listën e Mbrojtësve të Specializuar, se ai do ta pranonte emërimin dhe se ajo ishte në gjendje të ndërmernte hapa të menjëhershëm në këtë drejtim.⁶

II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

4. Sipas nenit 21(4)(e) të Ligjit, një i akuzuar ka të drejtën të mbrohet përmes Mbrojtësit të Specializuar të zgjedhur prej tij. Sipas nenit 21(5)(a) të Ligjit, i akuzuari është i detyruar të përfaqësohet nga Mbrojtësi i Specializuar gjatë kohës që është në paraburgim.

5. Sipas nenit 39(1) dhe (13) të Ligjit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mund të nxjerrë urdhra ose vendime që gjykohen të nevojshme për përgatitjen e një gjykimi të drejtë dhe të shpejtë.

6. Sipas pjesës 16(1) të Direktivës për Mbrojtësit,⁷ gjatë shqyrtimit të përfundimit para kohe të përfaqësimit të të akuzuarit nga Mbrojtësi i Specializuar, Administratori i kushton rëndësinë e duhur vazhdimin të përfaqësimit dhe duhet të marrë miratimin e panelit të ngarkuar me çështjen në të cilën vepron mbrojtësi.

III. DISKUTIM

⁵ Kërkesa, para. 1.

⁶ Kërkesa, para. 4, 8.

⁷ KSC-BD-04-Rev1, Administratorja, *Direktiva për Mbrojtësit*, 28 prill 2021.

7. Gjykatësi i Procedurës Paraprake merr parasysh parapëlqimin e deklaruar të z. Thaçi që të mos përfaqësohet më nga z. Huper dhe që z. Kihou të emërohet si mbrojtës i tij.⁸

8. Duke pasur parasysh të drejtat e z. Thaçi sipas nenit 21(4)(e) dhe (5)(a) të Ligjit dhe qëllimin e pjesës 16(1) të Direktivës për Mbrojtësit për të siguruar vazhdimësinë e përfaqësimit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon se kërkesa për përfundimin e parakohshëm të përfaqësimit të tij nga z. Huper mund të miratohet, nëse nuk pengon përfaqësimin efektiv të z. Thaçi.

9. Në këtë aspekt, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se Administratorja është në gjendje të ndërmarrë hapa të menjëhershëm për emërimin e z. Kihou si mbrojtës të z. Thaçi, për të siguruar që ai të jetë i përfaqësuar gjatë gjithë kohës.⁹ Gjithashtu, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vë në dukje zotimin e z. Huper se do t'i ofrojë mbrojtësit zëvendësues të gjithë ndihmën e nevojshme për transferimin e dosjes së çështjes.¹⁰ Gjithashtu, përveç mbrojtësit, që në fazat e hershme të procesit z. Thaçi është përfaqësuar edhe nga katër bashkëmbrojtës, të cilët janë të njohur me procedurat dhe çështjen gjyqësore kundër tij. Bazuar në sa më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake është bindur se përfaqësimi i efektiv i z. Thaçi është garantuar dhe rrjedhimisht miraton përfundimin e parakohshëm të përfaqësimit të tij nga z. Huper.

10. Z. Huper rikujtohet për detyrimet në vijimësi të tij sipas nenit 25 të Kodit të Etikës Profesionale.¹¹

⁸ Kërkesa, para. 2-3; Shtojca 1 e Kërkesës.

⁹ Kërkesa, para. 8.

¹⁰ Kërkesa, para. 9.

¹¹ KSC-BD-07-Rev1, *Kodi i Etikës Profesionale – për Mbrojtësit dhe Prokurorët para Dhomave të Specializuara të Kosovës*, 28 prill 2021.

IV. VENDIM

11. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

- a. **MIRATON** kërkesën për përfundimin e parakohshëm të përfaqësimit të z. Thaçi nga z. Huper;
- b. **URDHËRON** Administratoren të emërojë z. Kihou si mbrojtës të z. Thaçi menjëherë pas marrjes së njoftimit për këtë vendim; dhe
- c. **URDHËRON** Administratoren që brenda një jave nga marrja e njoftimit për këtë vendim, t'i dorëzojë Gjykatësit të Procedurës Paraprake njoftim në lidhje me emërimin e sipërpërmendur.

/nënshkrimi/

Gjykatësi Nikola Giju

Gjykatës i Procedurës Paraprake

E martë, 25 maj 2021

Në Hagë, Holandë.